



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

Rruga Ukshin Kovaqica, Mitrovicë, Republika e Kosovës
http://www.umib.net; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues
Dr. sc. Ali Topalli

Nr. Prot. 2445
Datë 29.11.2019

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 29.11.2019, mori:

VENDIM

- I. Për ndryshim dhe plotësim të emërimit të fushave të prorektorëve të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" si në vijim:
 1. Prorektori për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillim të cilësisë ndryshohet dhe plotësohet me emërtimin **"Prorektor për bashkëpunim ndërkombëtar dhe kërkime shkencore"**.
 2. Prorektori për mësimdhënie, çështje të studentëve dhe kërkime shkencore ndryshohet dhe plotësohet me emërtimin: **"Prorektor për mësimdhënie, çështje të studentëve dhe zhvillim të cilësisë"**.
- II. Vendimet për emërimin e prorektorëve të Universitetit të Mitrovicës duhet të ndryshohen sipas pikës I.1. dhe I.2. të këtij vendimi.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Këshilli Drejtues, pas shqyrtimit të propozimit të rektorit për ndryshim dhe plotësim të fushave të prorektorëve si në pikën I të këtij vendimi, e konsideroi të arsyeshëm propozimin pasi këto janë edhe rekomandime të ekspertëve ndërkombëtarë për akreditim dhe këto emërtime i përgjigjen më së miri fushëveprimtarisë së tyre për punë më efektive në Universitet. Bazuar në këtë që u cek si më lartë Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim i dorëzohet:

1. Arkivit të UMIB-it,
2. Zyrës së personelit;
3. Menaxhmentit.



Dr. sc. Ali Topalli

Kryesues i Këshillit Drejtues